



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 736/1 Prot.

Shkodër, më 5.11.2021

Lënda: Mbi Vendimin nr. 61, datë 26.10.2021 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, gërma a, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2, shkronja a, neni 54, shkronja e/1, neni 55, pika 4, të ligjit nr. 8744, dt. 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të palujtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, të VKM nr. 10, datë 07.01.2005 “Për miratimin e listës së pronave të palujtshme shtetërore në Komunën Vig Mnelë”, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës, e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Kreu I, pika 5, shkronja “a”, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 6278 prot., datë 01.11.2021 “Dokumentacioni shoqërues i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës të datës 26.10.2021”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 61, datë 26.10.2021 “Për miratimin e rinovimit të kontratës së subjektit ‘Albtelekom’ SH.A. për vendosje antenë së transmetimit të telefonisë celulare”, në pasurinë nr. 663, lloji truall, ZK 2708, fshati Mnelë e Vogël, NJAD Vig Mnel me sipërfaqe 150 m².

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni për dhënien me qira të sipërfaqes të caktuar në VKB, për një afat 1 vjeçar.


Lidhja apo nënshkrimi i kontratës në zbatim të nenit 9 pika 1.6/a dhe nenit 64/gj të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, është tagër i Kryetarit të Bashkisë.

Elementi i rinovimit¹ të kontratës mund të aplikohet nëse ka qenë pjesë përbëse e kontratës dypalëshe me të njëjtin subjekt dhe ky operator ka plotësuar të gjitha detyrimet që ka patur ndaj bashkisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI



¹ Tregoni vëmendje në terminologjinë e cituar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr ----- Prot.

Vau Dejës me ____ . ____ 2021

VENDIM

Nr 61 datë 26.10.2021

**PËR MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATËS SË SUBJEKTIT “ALBtelekom”
SH.A, PËR ANTENEN E TRANSMETIMIT TË TELEFONISË CELULARE**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2021, me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur në neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1,2, neni 18, neni 54 shkronja e/1(ndryshuar), neni 55 pika 3, neni 64 germa “c”, “gj”, ligji nr 38/2019, ligji nr 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar, në VKM nr 10 dt 07.01.2005, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore në Komunen Vig Mnelë, në VKM nr 54 datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar, me shumicë të cilësuar votash:

VENDOSI

1. Miratimin e rinovimit të kontratës së subjektit “ALBtelekom” Sh.a, për antenë celulare, në pasurinë nr 663, e llojit **Truall**, Zk 2708, në fshatin Mnelë e vogël, me sipërfaqe 150 m2.
2. Afati i dhënies me qira të jetë 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi.
3. Efektet: Jep impakt pozitiv, dhe sigurohen të ardhura që kthehen në investime publike.
4. Vlera e dhënies me qira të jetë sipas raportit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM-së nr 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata tjera të pasurisë shtetërore”
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETAR

Mark BISHA

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 01.11.2021

